

### Backer, Reineck and Duijzings – Western anthropology in the socialist Kosova

**Abstract:** *This essay takes in consideration the most fundamental contribution of Berit Backer, Norwegian, Janet Reineck, American and Ger Duijzings, Dutch, three western anthropologists who included Kosova in the map of comparative anthropology during the Yugoslav socialist rule.*

*After the closure of communist Albania, Kosova offered a rather free terrain where ethnographic research could explore changes in the Albanian family and society. For instance, Backer (Isniq, 1974–1975) demonstrated that the Albanian family is not a frozen relict but a rather dynamic institution which is continuously reorganised according to the rules of the organisation of the «home» and the conditions of the socialist modernism.*

*Reineck (Opojë, in the 1980s) initially saw the wedding as an enactment and symbolism of cultural worldview. He then commented on the «past as a shelter», because migration frequently enhanced patriarchal conservatism. In fact, the figure of landlady stewarded the scheme of gender control.*

*Duijzings (end of the 1980s and beginnings of the 1990s) deconstructed ethnical and religious essentials by pointing out to the fluidity of identity in Anamoravë through jointed pilgrimages, syncretic rites of Crypto-Catholics and orders of dervishes. So, religion appeared intertwined with identity policies. These three musketeers gave life to an ethnographic register of social transformation in Kosova. They also represent an vector ranging from the structural functioning of the family (Backer) and the symbolic/performative and gender analysis of tradition (Reineck) to the postmodern de-essentialising perspectives of identity (Duijzings).*

*Commenting on their scholarly contribution shifting the focus from tradition as a quintessence to the processes of change, the essay attempts to highlight that their stance connected Kosova with European debates on socialism, migration, gender, and religion. It also suggests that a contemporary ethnographic re-reading of these topics is needed.*

**Keywords:** *Kosova, anthropology, socialism, Berit Backer, Janet Reineck, Ger Duijzings.*

## Kosova në peizazhin antropologjik të Jugosllavisë socialiste

Pas hovit të studimeve të etnografëve të huaj mbi kulturën shqiptare, që patën në fillim të shekullit XX, pasoi një periudhë e detyruar e heshtjes. Në Shqipërinë komuniste, antropologët e huaj nuk u lejuan të hyjnë, të vrojtojnë e të studiojnë shoqërinë shqiptare; diktatori Enver Hoxha e shkëputi dhe e izoloi vendin nga shkenca e hapur perëndimore. Shqipëria zhvilloi një shkencë ideologjike nën diktatin e regjimit enverist.<sup>1</sup> Ndërkaq, në Kosovë, si pjesë e Jugosllavisë, mundësitë për kërkime ishin më të hapura.<sup>2</sup> Jugosllavia lejoi bashkëpunimin shkencor deri në masën sa nuk cenon kredibiliteti i sistemit titist, ku etnologët shqiptarë patën mundësi të krijojnë furrikun albanologjik brenda kontekstit jugosllav.<sup>3</sup> Një numër i vogël i antropologëve të huaj zuri vend në Jugosllavi, ku prej më të njohurve ishin Joel dhe Barbara Halpern (me fokus në fshatin serb),<sup>4</sup> Eugene Hammel (po ashtu në Serbi)<sup>5</sup>, William Lockwood (në Bosnjë),<sup>6</sup> e disa të tjerë. Ndërsa në Kosovë, deri në vitin 1974, nuk pati projekte antropologjike perëndimore të ndërlidhura me institucione akademike. Duket se me ndryshimet kushtetuese të vitit 1974, filluan edhe ndryshimet në raportin e Kosovës me botën akademike perëndimore. E para që u zhdorgj në Kosovë me projekt institucional qe antropologia norvegjeze nga Universiteti i Oslos, Berit Backer, e cila e vendos fshatin Isniq afër Deçanit, për të realizuar vrojtimit e saj etnografike gjatë viteve 1974/1975 dhe mbrojtur tezën e masterit në vitin 1979.<sup>7</sup> Vepra e saj u bë referencë

- 1 A. Hysa, *Ethnography in Communist Albania: Nationalist Discourse and Relations with History*, "Historični seminar" (2010) 8, f.103-125; N.Bardhoshi & O. Lelaj, *Etnografi në diktaturë: dija, shteti dhe holokausti ynë*, ASHSH Tiranë, 2018; M.Galaty & C.Watkinson, *The Practice of Archaeology under dictatorship*, in M.Galaty & C. Watkinson (eds). *Archaeology Under Dictatorship*, Springer, NY, 2007, 1-18;
- 2 N. Bardhoshi & A. Canolli, Kosova antropologjike, në N.Bardhoshi & A.Canolli (eds) *Kosova Antropologjike*, ASA, Tiranë 2020, f. 7-50
- 3 A. Canolli, "Nga gurra e traditës te gurra e kritikës": aspekte të mendimit etnologjik të Mark Krasniqit, "Antropologjia", 3/1, 2020, f.5-42
- 4 J. Halpern, *A Serbian Village, second edition*, Harper, NY, 1967
- 5 E. Hammel, *Alternative Social Structures and Ritual Relations in the Balkans*, Englewood Cliffs, New Jersey: Prentice Hall,; E. Hammel, *Economic Change, Social Mobility and Kinshtip in Serbia*, "SouthWestern Journal of Anthropology", 1968, 25, f.188-197
- 6 W. Lockwood, *European Moslems; economy and ethnicity in Western Bosnia*, Academic Press, New York, 1975
- 7 Tema e saj e magistraturës (MA) u mbrojt në Universitetin e Oslos në vitin 1979 nën titullin *Behind Stone Walls: Changing Household Organisation Among Albanians in Kosovo*. Kjo temë u botua dy herë si libër, në gjuhën angleze, nën redaktimin e Robert Elsie-t dhe Antonia Young-ut, në vitin 2003 dhe 2015. Ndërsa në vitin 2025, u përkthye dhe u botua në gjuhën shqipe. Shih: B. Backer, *Prapa mureve të gurit: ndryshimi në organizimin e familjes te shqiptarët e Kosovës*, Cuneus, Prishtinë, 2025. Versioni në gjuhën shqipe është më ploti sepse përfshin edhe dy kapituj të papërfshirë në botimet

themelore për studimet e mëvonshme antropologjike të antropologëve të huaj, por nuk gjeti vendin e duhur në etnologjinë shqiptare deri së voni. Në vitet '80, kultura shqiptare e Kosovës u bë temë e antropologes amerikane Janet Reineck, e cila fillimisht shkroi një temë studimore të nivelit postdiplomik<sup>8</sup> mbi vallet e dasmës të shqiptarët e Kosovës dhe më pas hulumtoi dhe shkroi temën e doktoratës mbi gjininë, migrimin dhe ideologjinë, me fokus në rajonin e Opojës.<sup>9</sup> Ndërsa në fund të viteve 80 dhe në fillim të viteve '90, hapjes së shtegut iu bashkua antropologu holandez Ger Duijzings, që studioi identitetin etnik e fetar, rolin e religjionit dhe mënyrat e ndërthurjes së tyre në shoqërinë kosovare - jo vetëm të shqiptarët, por edhe të komunitetet e tjera - duke u fokusuar në disa vende, por kryesisht në rajonin e Anamoravës në Kosovë.<sup>10</sup> Këta tre antropologë duam t' i emnojmë si "tre musketarët"<sup>11</sup> e antropologjisë perëndimore në Kosovë, të cilët Kosovën e shndërruan në një referencë të krahasueshme antropologjike për rajonin.

Duhet theksuar se në vendet komuniste të Evropës Juglindore, gjatë periudhës së komunizmit u zhvillua një etnologji specifike ideologjike, ku perspektiva kryesore e etnologëve vendës ishte marksizmi dialektik dhe tradita gjermane *Volkskunde*, ndërsa tematika kryesore ishin karakteri-

---

tjera dhe po ashtu parathënien nga redaktori, Tahir Latifi dhe mikja e Backer-it dhe fotografia Ann Christike Eek. Botimi në shqip përfshin edhe fotografi të Backer-it, që mungojnë në verzionet tjera dhe fotografi të kohës (1976) nga Ann Christine Eek, e cila e vizitoi Kosovën, për çka shkroi edhe një libër kujtimor. Këtij botimi do t' i referohemi në gjuhën shqipe.

- 8 J. Reineck, *Wedding Dances from Kosovo, Yugoslavia: A Structural and Contextual Analysis*, UCLA, (MA Dissertation), 1985. Kjo temë e disertacionit nuk është botuar në gjuhën angleze, por pritet të përkthehet e botohet në gjuhën shqipe.
- 9 J. Reineck, *The Past as a Refuge: Gender, Migration and Ideology among the Kosova Albanians*, PhD Dissrtation, University of California at Berkeley, 1991. Kjo tezë e doktoratës është përkthyer në gjuhën shqipe në vitin 2024, si: J. Reineck, *E kalura si strehë: Gjinia, migrimi dhe ideologjia të shqiptarët e Kosovës*, Cuneus, Prishtinë, 2024. Versioni në gjuhën shqipe përfshin edhe një hyrje të re të autores ["*Parathënie e botimit në gjuhën shqipe: Transformimi i Kosovës*", f. 13-21]
- 10 G.Duijzings, *Religion and Politics of Identity in Kosovo*, Hurst, London, 2000. Ger Duijzings mbron doktoratën në vitin 1999, ndërsa librin e bazuar mbi doktoratë e boton në vitin 2000. Ky libër vjen në gjuhën shqipe tek në vitin 2024. Shih: G.Duijzings, *Religjioni dhe politikat e identitetit në Kosovë*, Cuneus, Prishtinë, 2024.
- 11 I kemi quajtur musketarë për të konotuar kureshtjen dhe guximin intelektual për të hapur shteg të ri të hulumtimit dhe pasionin për të vërtetën shkencore, duke u bazuar mbi evidenca empirike. Po ashtu ata shquhen edhe për ngulmimin për të mos hequr dorë për ta bërë të njohur popullin e Kosovës në vllugun e ndryshimeve të mëdha në kontekst të një regjimi komunist, siç ishte Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë. Ndonëse nuk kanë qenë në terren së bashku, këta antropologë kanë punuar pothuajse në të njëjtën kohë brenda gjeografisë së njëjtë politike e kulturore.

stika dhe traditat popullore të popujve të shtetit relevant.<sup>12</sup> Etnologjia u bë “shkenca e traditës”, me një rol esencalist që “identifikon, ruan, rekomandon, përjashton kulturën në kontekst të legjitimitetit të ideologjisë nacional-komuniste”.<sup>13</sup> Në Shqipërinë komuniste, etnologjia u zhvillua nën një presion shumë më të drejtpërdrejtë të pushtetit shtetëror,<sup>14</sup> krahasuar me situatën në Jugosllavi<sup>15</sup>, apo në Bullgari.<sup>16</sup> Edhe në Rumaninë çausheskiane, sikurse në Shqipërinë enveriste, etnologjia u shndërrua po aq thellësisht në një instrument të hapur të ideologjisë zyrtare, duke u shfrytëzuar jo vetëm për të mbështetur narrativat e regjimit, por edhe për të përligjur një model të unifikuar kulturor në përputhje me kërkesat ideologjike të kohës.<sup>17</sup> Pra, në të gjitha këto vende komuniste etnologjia e humbi autonominë e saj shkencore dhe u kthye në një mekanizëm të qartë të pushtetit ideologjik. Madje, jo vetëm etnologjia por edhe historiografia pati të njëtin fat të vazalizimit ideologjik ndaj sistemit komunist diktues ndaj shkencës.<sup>18</sup> Duhet të theksojmë, po ashtu, se rasti i Jugosllavisë nuk është njësoj sikurse ai i Shqipërisë dhe Rumanisë,<sup>19</sup> por fakti se ekzistonte

12 V. Godnina, *From Ethnology to Anthropology and Back Again: Negotiating the Boundaries of Ethnology and Anthropology in Post-socialist Euro pean Countries*, in Skalnik P. (ed.) *A Post-communist Millennium: the Struggles from Sociocultural Anthropology in Central and Eastern Europe*, Prague: Set Out, 2002, f.1-22.

13 A. Canolli, *Rrënjë, rrugëtime, rropatje: interpretime antropologjike*, Cuneus, Prishtinë, 2022, f. 112

14 A. Hysa, *Ethnography in Communist Albania: Nationalist Discourse and Relations with History*, f.103-125; N.Bardhoshi & O. Lelaj, *Etnografi në diktaturë: dija, shteti dhe holokausti ynë*, 2018; N. Bardhoshi, “Ethnography of Law in Dictatorial Situation”, in A. Bošković & C.Hann (eds) *The Anthropological Field on the Margins of Europe 1945-1991*, Berlin: Lit Verlag, 2013, f.175-189.

15 C. Hann, *Introduction: Nations and Nationalism, Societies and Socialism, Fields and Wars*, in A. Bošković & C.Hann (eds) *The Anthropological Field on the Margins of Europe 1945-1991*, Berlin: Lit Verlag, 2013, f. 1-28,; D.R.Auguštin, *Ethnology, Myth and Politics: Anthropologizing Croatian Ethnology*, Burlington, Ashgate, 2004; S. Pokonjak, *In Women's Arms: Croatian Ethnology between 1945 and 1990*, in A. Bošković & C.Hann (eds) *The Anthropological Field on the Margins of Europe 1945-1991*, Berlin: Lit Verlag, 2013, f. 237-258

16 G. Valtchinova, *Folkloristic Ethnography or Anthropology: Bulgarina Ethnology at the Crossroads*, “Journal of Society for Society of Europe”, 2004, 4/2, f.2-18.

17 O. Hedeşan, *Doing Filedwork in Communit Romania*, in Mihăilescu, I. Iliev and S. Naumović (eds), *Studying Peoples in the People's Democracies II*, LIT Verlag, 2008, f.21-39

18 U. Brunnbauer, *A Promising Liasion? Social History and Anthropology in Southeastern Europe: Opportunities and Pitfalls*, “East Central Europe/ECE”, 34-35, (2007-2008), 1-2, f.161-184

19 Chris Hann ofron një pamje të njëfarë diversiteti rrymash e perspektivash brenda etnologjisë jugosllave, ku kroatët e sllovenët kishin nisur të përvetësonin teori të kohës nga rrymat përndimore (shih: Hann, 2013: 6)

një kornizë ideologjike e propozuar nga shteti, apo një mekanizëm i etabluar ideologjikisht i kontrollit të cilësisë akademike, tregon për mungesë të lirisë akademike dhe kontroll ideologjik në mendimin akademik. Në shumicën e regjimeve komuniste, kultura publike kaloi përmes një shoshitje të hollë dhe të gjithanshme, që nuk ishte vetëm shprehje nostalgjike për një të kaluar që tashmë po zhdukej, por edhe një strategji politike-ideologjike për të krijuar bashkimin apo mishërimin me Partinë dhe për shndërruar fshatarët në punëtorë<sup>20</sup>. Në këtë kontekst, etnografët realizuan ekspedita të shumta nëpër fshatra, duke regjistruar e sistematizuar “kulturën popullore”, pikërisht në një kohë kur vetë kulturat tradicionale fshatare po shpërbëheshin nën ndikimin e modernizimit socialist.<sup>21</sup>

Asgjëmang, në të gjitha vendet komuniste të Evropës Juglindore, pos Shqipërisë, antropologët perëndimorë u lejuan të bëjnë hulumtime në “terrenin” e tyre, të vrojtojnë dhe të studiojnë shoqërinë komuniste/socialiste, ndonëse duke u fokusuar te kultura popullore, fshati dhe zakonet, të cilat formësonin identitetin etnik e kulturor të vendit. Në Jugosllavi hynë, mes tjerëve, Joel Halpern<sup>22</sup> dhe William Lockwood<sup>23</sup>, ku të dy realizuan vrojtme në zona rurale duke u marrë me jetën në fshat, me “zadrugën” dhe aspekte të “kulturës fshatare” në kontekst të ndryshimit ekonomik në Jugosllavi.<sup>24</sup> Po ashtu, edhe në Bullgari pati antropologë të huaj, ashtu sikurse edhe në Rumani.<sup>25</sup> Pra, vendet komuniste të këtij rajoni u bënë objekt i venerimit antropologjik nga perëndimorët, të cilët u fokusuan kryesisht te “kultura popullore” e këtyre vendeve, dhe zhvillimet e ndryshimet shoqërore-ekonomike në fshatin socialist. Deri në vitet ‘70, tematika e antropologëve të huaj nuk dalloi shumë nga ajo e etnologëve vendës, sepse “fshati” qe qendra e vrojtimit, por qasja dhe perspektivat por

20 C. Silverman, *The Politics of Folklore in Bulgaria*, “Anthropological Quarterly”, 56 (1983) 2, f. 55-61

21 R. Ivanova, *New Orientations in Bulgarian Ethnology and Folkloristics*, “Ethnologia Balkanica”, 2 (1998), f.225

22 J. Halpern, *A Serbian Village in Historical Perspective*, 1967

23 W. Lockwood, *European Moslems; economy and ethnicity in Western Bosnia*, Academic Press, New York, 1975

24 Edhe në republikat tjera jugosllave pati antropologë që bënë studime mbi jetën në fshat: Shih: C. Boem, *Blood revenge : the anthropology of feuding in Montenegro and other tribal societies*, Kansas, University Press of Kansas, 1984; J. Obrebski, *Ritual and social structure in a Macedonian village*, Amherst, University of Massachusetts, 1977, I. Winner, *A Slovenian village: Žerovnica*, Providenca, R.I, Brown University Press, 1971

25 Timothy Rice punoi në Bullgari si etnomuzikolog gjatë periudhës komuniste, ndërsa Gerald Creed ishte atje në përfundim të komunizmit, gjegjësisht nga vitit 1987 dhe vazhdoi në vitet ‘90. Shih: T.Rice, *May it Fill Your Soul: Experiencing Bulgarian Music*, Chicago, Chigago Unuversity Press, 1994 dhe G. Creed, *Domesticating Revolution: From Socialist Reform to Ambivalent Transition in a Bulgarian Village*, Pennsylvania, Pennsylvania State University Press, 1998.

edhe interpretimet analitike dolën të jenë goxha të ndryshme.<sup>26</sup> Pra, edhe antropologët perëndimorë u fokusuan kryesisht në zona rurale dhe ishin gjatë gjithë kohës të mbikqyrur, të kontrolluar e të vëzhguar nga sistemi, gjegjësisht shërbimet inteligjente të vendeve ku studionin (Verdery).<sup>27</sup>

Kosova ishte një nga zonat më të varfëra dhe më të neglizhuara të Jugosllavisë. Duke qenë se kishte mbetur nën regjimin jugosllav, pa dëshirën e shumicës shqiptare, por me synimet revolucionare ideologjike të komunistëve, dhe për shkak se kishte qenë fokus i etnonacionalizmit çetnik serb, nuk pati vëmendjen e antropologëve të huaj deri në vitin 1974, kohë kjo që korrespondon me ndryshimet kushtetuese që i dhanë pozitë Kosovës, si krahinë autonome e federatës jugosllave, por me të drejta mjaft substanciale.<sup>28</sup>

Megjithatë, Kosova nuk mbeti e anashkaluar nga antropologjia perëndimore që interpretonte Evropën Juglindore falë kureshtjes së tre antropologëve të lartpërmendur: Berit Backer, Janet Reineck and Ger Duijzings. Këta studiues e vendosën Kosovën në hartën e antropologjisë botërore, dhe studimet e tyre ofruan një vërejtje antropologjike mjaft të rëndësishme për antropologjinë e socializmit, që nuk është vlerësuar sa duhet në kritikën antropologjike. Në këtë esë, do të bëjmë një diskutim të shkurtër mbi specifikat e interpretimeve të këtyre tre antropologëve që studiuuan në Kosovë, duke u fokusuar në monografitë e tyre përkatëse, dhe mbi peshën që marrin këto studime si katalogje antropologjike që regjistrojnë ndryshimet / transformimet e shoqërisë shqiptare në Kosovë, në një mënyrë të ndryshme nga etnologjia shqiptare që zhvillohej në Kosovën e atëbotshme.

## Tre musketarët

Legacia e etnografisë perëndimore parakomuniste mbi shqiptarët dhe Shqipërinë, ajo e fillimshkullit të XX-të, ishte ende prezente në literaturën

---

26 Sa i përket Jugosllavisë, si Halpern, ashtu edhe Hammel dhe Lockwood, shqyrtojnë aspekte të funksionit dhe simbolikave të jetës fshatare, si në kontekst historik ashtu edhe në kontekst strukturor e funksionalist, duke pasur kryesisht një qasje sa antropologjike aq edhe historiografike.

27 Për një pamje specifike se si antropologët qenë vëzhguar nga sigurimi shtetëror shih diskutimin e Katherine Verdery-t pasi kishte gjetur fajllat e sigurimit rumun për qëndrimin dhe punën e saj si antropologe në Rumaninë komuniste, tek në vitet e 2000-ta: K. Verdery, *My Life as A Spy: Investigations in A Secret Police File*, Durham, Duke University Press, 2018. Po ashtu shih edhe: Hann, C. *Beyond Cold War, beyond otherness: some implications of socialism and postsocialism for anthropology*, In C. Giordano, F. Ruegg, & A. Boscoboinik (eds.), *Does east go west?: anthropological pathways through postsocialism*, Münster, LIT, 2014, 35-56; K. Verdery, *What Was Socialism and what Comes Next?* Princeton, NJ: Princeton University Press, 1996

28 N. Malcolm, *Kosovo: A Short History*, Basingtoke, Macmillan, 1998

antropologjike. Antropologë eminentë si Robert Lowie, Ernst Gellner, Jack Goody, e shumë të tjerë ende bazoheshin te referencat e dhëna në gjuhën angleze nga Edith Durham, Margaret Hasluck, Rose Wider Lane, të cilët, interpretuan kulturën shqiptare, në kontekst të përgjithshëm, si të “ngrirë” në kohë; një kulturë me sistem specifik oral të kujtesës brenda familjes e fisit, që mbarte “survivanca” të lashta. Në anën tjetër, në Shqipërinë komuniste, pas vitit 1945, nuk qenë lejuar të hynin antropologët përendimorë për të studiuar gjendjen, ndryshimet e transformimet që po i ndodhnin kësaj shoqërie, të cilën e kishte kapluar drejtimi diktatorial komunist i Enver Hoxhës. Kosova mbeti i vetmi vend ku mund të studiohej kultura shqiptare, në kontekst të “stagnimit” dhe “ndryshimit” të familjes, fshatit, traditës e identitetit. Jugosllavia kishte nisur bashkëpunimet me antropologjinë përendimore, duke akomonduar fillimisht Joel Halpern-in në Serbi, qysh në fillim të viteve '50. Por, në vitin 1974, Kosova bëhet pjesë e hartës së terrenit hulumtues të antropologjisë përendimore me vizitën studimore të Berit Backer-it në fshatin Isniq.

### ***Berit Backer***

Berit Backer kishte vizituar Shqipërinë komuniste në vitin 1969 si studente e re e antropologjisë në Universitetin e Bergenit. Shqipëria shihej në sytë e botës përendimore, si “fanar i socializmit”.<sup>29</sup> Për të rinjtë progresivë që jetonin në botën përendimore, sidomos në vendet ku mbretëronte një lloj socialdemokracie, socializmi-komunizmi ishte një lloj utopie e synuar politike. Për disa, Shqipëria shihej si vendi që kishte nisur ngritjen e kësaj utopie. Backer e kishte vizituar disa herë Shqipërinë komuniste, si udhërrëfyese e grupeve vizitore-turistike, por nuk kishte arritur të merrte leje nga regjimi që të realizonte hulumtim antropologjik atje.

Një prej shoqëruesve të saj në Kosovë, Ann Christine Eek, kujton:

“Gjatë vizitës së parë në Shqipëri, Berita u magjeps nga njerëzit, kultura dhe lufta e tyre e pareshtur për pavarësi. Ajo vendosi t’ua kushtonte kërkimin e saj në antropologjinë sociale shqiptarëve dhe u përgatit me kujdes, me shpresën se do të mund të jetonte në Shqipëri për një vit, një pjesë të të cilit donte ta kalonte në një fermë shtetërore. Ajo dëshironte të studionte se si ky popull, shumica dërrmuese e të cilit s’dinte shkrim e këndim para Luftës së Dytë Botërore, kishte “arritur të ruante kulturën dhe gjuhën e tij të veçantë me gjithë shtypjen e vazhdueshme nga vende të tjera...” dhe njëkohësisht ta zhvillonte vendin në një shtet modern.”<sup>30</sup>

29 A.C. Eek, *Berita: Mikesha norvegjeze e shqiptarëve*, në Berit Backer, *Prapa mureve të gurit: Ndryshimi në organizimin e familjes te shqiptarët e Kosovë*, Cuneus, 2024, f.18

30 Po aty, 18

Ndonësë Berita u vendos në Kosovë, ajo gjithmonë kthente vëmendjen edhe kah Shqipëria. Kjo dihet nga vizitat e saj si udhërrëfyese e organizatave të “miqësisë” në Shqipëri. Po ashtu, nuk duhet harruar se Berita kthehet dhe realizon një film etnografik në vitin 1991, pikërisht mbi kthimin e tokës së kooperativizuar nga shteti, në vllug të shpërthimit të ligjit 7501, që parlamenti shqiptar kishte nxjerrë asaj pranvere. Pa dyshim, mësojmë se në vitet '80, pas gati 6 vitesh vizita të pandërprera në Shqipëri, Berita kupton “se “Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë” nuk ishte parajsë”.<sup>31</sup>

Për Berit Backer-in, Kosova u bë zëvendësim i Shqipërisë së mbyllur për antropologët e huaj. Ajo përfaqësonte një hapësirë studimi që kombinonte dy elemente thelbësore për kërkimet e saj: një shoqëri shqiptare, të cilës ajo ia kishte kushtuar pasionin dhe interesin e hershëm shkencor, dhe një kontekst socialist ku mund të hulumtonte jetën shoqërore dhe familjen e madhe shqiptare në kushtet e transformimeve që po sillte projekti vetëqeverisës i Jugosllavisë. Pas Luftës së Dytë Botërore, studimet mbi familjen dhe farefisën kishin fituar një vend të rëndësishëm në antropologjinë jugosllave. Serbia, përmes fenomenit të *zadrugës* (bashkimit të disa njësisë familjare në një familje të madhe me një udhëheqës të zgjedhur), u bë qendër e këtij debati. Joel Halpern dhe antropologë të tjerë përëndimorë ia kushtuan një sërë botimesh këtij institucioni, duke e parë si një dritare për të reflektuar mbi universalitetin dhe partikularitetin e familjes nga një këndvështrim antropologjik.<sup>32</sup> Duket se në këtë kontekst metodologjik e intelektual, por edhe në kontekst të yshtjes konceptuale të utopisë socialiste, Berit Backer-i zgjodhi të vendosej për dy vite në Kosovë, në fshatin Isniq, dhe shkroi një etnografi të thelluar mbi familjen shqiptare.

Qëllimi i saj ishte të kuptonte mënyrat dhe format e ndryshimit në familjen rurale, nën kushtet e modernizimit socialist. Ajo vërejti se modernizimi i shoqërisë nuk mund të shpjegohej si një proces linear i kalimit nga “familja e madhe patriarkale” në “familjen moderne nukleare”. Përkundrazi, argumenti qendror i saj ishte se ndryshimet në madhësi dhe tipologji të familjes nuk shpjegoheshin vetëm nga faktorë demografikë, por nga proceset shoqërore e kulturore dhe, mbi të gjitha, nga ciklet zhvillimore të vetë shtëpisë. Siç thekson ajo, “hipoteza ime është vërtetuar në shumë mënyra. Por, korrelacioni ndërmjet ‘modernizimit’ dhe ‘lindjes së familjes nukleare’ nuk është marrëdhënie e qartë dhe e drejtpërdrejtë. Historia bën lakadredha dhe njerëzit priren të rihartojnë qëllimin e institucioneve

---

31 Po aty., 20.

32 Për një vështrim kritik mbi institucionin e *zadrugës*, ku ofrohet edhe diskutimi i përgjithshëm mbi këtë literaturë, shih. M. Todorova, *Myth-Making in European Family History: the Zadruga Revisited*, “East European politics and societies”, 1990, 4/1, f. 30-76

të tyre tradicionale sociale”<sup>33</sup>. Në këtë kuptim, ajo arsyetoi se familjet e mëdha në Kosovë nuk duhet parë si mbetje arkaike, por si struktura që riorganizohen për t’iu përshtatur kushteve të reja. Familja shqiptare në Kosovë nuk është një tip statik, por një institucion që kalon përmes fazave dhe formave të ndryshme gjatë ciklit të saj zhvillimor. Pra, shpjegimi i familjes nuk qëndron në mitin e “familjes tradicionale të madhe”, por te kombinimi i faktorëve shoqërorë, ekonomikë dhe kulturorë që ndikojnë në evolucionin e saj.

Etnografia e Backer-it ofron përshkrime të hollësishme të jetës në fshat dhe të përpjekjeve të banorëve për t’u adaptuar ndaj sistemit të ri socialist. Ajo dokumenton ndarjen e familjeve, shkollimin, punën në bujqësi, mikpritjen, nderin, sjelljen e grave, migrimin dhe punësimin. Për shembull, familjet shqiptare nisën ta përdornin migrimin në Evropën Perëndimore si strategji për të siguruar të ardhura. Por, ajo thekson se ky proces solli edhe pasiguri të reja për gratë, të cilat duhej të bartnin mbi vete mbrojtjen e nderit dhe ruajtjen e rendit të shtëpisë. Kështu, migrimi nuk e dobësoi thjesht familjen, por e riorganizoi atë, duke i ndryshuar rolet gjinore dhe duke gjeneruar tensione të reja shoqërore. Në marrëdhënie me pushtetin politik, Backer-i vërejti se strukturat tradicionale të autoritetit nuk u zhdukën nga institucionet komunale. Përkundrazi, ato bashkëjetuan.

“Partia përfaqësonte “Jugosllavinë,” pleqësia traditat sociale. Partia u bë simbol i modernizimit dhe integritit kombëtar. Pleqësia mbronte “identitetin etnik shqiptar.””<sup>34</sup>

Autoriteti moral, i bazuar në traditë dhe normë zakonore, kishte peshë më të madhe sesa autoriteti ligjor i Partisë. Edhe pse pleqësia humbi një pjesë të ndikimit të saj me ardhjen e institucioneve komunale, ajo vazhdonte të kishte peshë të madhe në zgjidhjen e konflikteve dhe në ruajtjen e traditës. Kjo tregon se modernizimi nuk e zhduku autoritetin tradicional, por e shtyu të bashkëjetonte me format e reja shtetërore. Ky është një nga vërtetimet më të rëndësishme të saj, sepse shfaq një proces të ndërmjetëm të modernizimit, ku pushteti tradicional dhe ai shtetëror ndërthuren dhe shpesh konkurrojnë. Duhet theksuar edhe se risia që solli venerimi autentik i Backer-it, nuk u perkthye në perspektivë referenciale për etnologjinë vendore. Për dallim nga kjo qasje qasje dinamike dhe analitike, etnologët vendorë e kishin trajtuar familjen kryesisht si një kategori të qëndrueshme dhe përfaqësuese të identitetit kulturor kombëtar. Për shembull, Mark Krasniqi e përshkruante familjen e madhe patriarkale si tipar themelor të shoqërisë shqiptare, duke i dhënë më shumë rëndësi autenticitetit dhe

33 Backer, *Prapa mureve të gurit*, f.33

34 Po aty, 143

trashëgimisë sesa proceseve të brendshme të ndryshimit.<sup>35</sup> Për pasojë, studimet vendore shpesh mbeteshin përshkrime të simbolikës, pa analizë të dinamikës së brendshme. Backer-i, në të kundërtën, tregoi se familja shqiptare ishte një institucion që “vazhdimisht riorganizohet”, duke qenë se tiparet e saj shfaqen në forma të ndryshme sipas kontekstit historik, ekonomik dhe kulturor. Madje, ajo kishte analizuar edhe arsytet historike, politike e ekonomike të krijimit / vazhdimit të familjeve të mëdha shqiptare në Isniq, në kontekstin e sundimit osman dhe ndryshimet që erdhën pastaj. Po ashtu, duhet theksuar se Backer e vendosi rastin e Isniqit në një kornizë teorike globale, duke e krahasuar me studime të tjera mbi familjen dhe duke debatuar drejtpërdrejt me nocionin e “mitit të familjes së madhe tradicionale”, të ngritur nga Laslett, Halpern dhe Goody<sup>36</sup>. Përmes kësaj qasjeje, ajo e bëri Kosovën pjesë të një debati më të gjerë antropologjik, duke e larguar nga kufijtë e ngushtë nationalistë dhe ideologjikë.

Për me ia lidhë kryet këtij venerimi, duhet të kumtojmë se studimi i Berit Backer-it përfaqëson një moment të rëndësishëm në historinë e antropologjisë së Kosovës dhe të studimeve mbi familjen shqiptare. Ajo e paraqet familjen jo si një relik të së kaluarës apo si shenjë identitare të pandryshueshme, por si një institucion dinamik që përshtatet e transformohet. Siç përmbledh ajo, “familja e madhe nënkuptonte forcë”<sup>37</sup>, dhe kjo strukturë ishte një strategji për të mbijetuar përballë pushtimeve, taksave dhe mësymjeve të huaja. Kjo strategji e mbijetesës shpjegon jo vetëm të kaluarën, por edhe elasticitetin e familjes shqiptare përballë modernizimit socialist, migrimit dhe sfidave të kohës. Kësisoj, Backer-i i dha studimit të familjes shqiptare një dimension të ri: ajo e pa si proces dhe jo si strukturë të ngrirë.

### **Janet Reineck**

Janet Reineck ka bërë vrojtimin më të gjatë të shoqërisë shqiptare në Kosovë si antropologe e huaj. Ajo viziton Kosovën në vitin 1981 dhe pastaj qëndron disa vite si studiuese e valles në dasmë, në Opojë, por duke vizituar edhe Hasin, Rugovën, Gollakun e vise të tjera. Pastaj kthehet edhe për studimet doktorale në fund të viteve '80, të cilat i përfundon në vitin 1991, me mbrojtjen e disertacionit të saj. Gjatë viteve '90 ajo kthehet në Kosovë, si aktiviste humansite dhe largohet në vitin 1997.<sup>38</sup> Pastaj, në vitin 2024 kthehet prapë për të jetuar përgjithmonë në Kosovë.

35 Për një diskutim të gjerë të veprës së Mark Krasniqit, shih: Canolli, *Rrënjë, rrugëtime, rropatje*, f.111-148

36 Shih diskutimin: Backer, *Prapa mureve të gurit*, f.35-37

37 Po aty, f.34

38 Për më shumë rreth rrugëtimit të saj shih: J.Reineck, 2022, *Një Amerikane në Kosovë 1981-1997*, Cuneus, Prishtinë.

Tema e studimeve postdiplomike MA e mbrojtur në vitin 1985, mund të konsiderohet si një analizë strukturore e valleve të dasmës, duke i parë vallet si “ngjarje” kulturore, jo si performanca të leçitura. Pra, Janet synon studimin e valles në kontekst të studimit të gjerë kulturor, përkatësisht “të gjitha aspektet e sjelljes si vallja, muzika, kënga dhe traditat rituale në dasmën opojane shihen, jo si produkte kulturore, por si procese dinamike.”<sup>39</sup> Metodologjia e saj ishte pothuajse krejt e ndryshme nga etnologët e folkloristët vendës të cilët mbledhnin evidenca për t’i shndërruar në tekst përshkrues të shkurtër, përderisa Reineck që zhytur në jetën e vendësve duke u bërë pjesëmarrëse në valle, dasma, ndeja e jetë të përditshme. Ajo thekson se “gjatë dasmave vallëzoja dhe këndoja me vajzat dhe gratë e fshatit, duke u përfshirë në gjendjen e tyre të thellë emocionale gjatë këtyre ngjarjeve.”<sup>40</sup> Në këtë frymë etnografike, përmes valles së dasmës si ngjarje specifike Reineck rrëfen botën shqiptare të Kosovës, prej mikpritjes deri te identiteti etnik. Por, një prej karakteristikave kryesore të kësaj teme është dokumentimi i valleve dhe i dasmës në përgjithësi, si një trashëgimi kulturore shpirtërore e rajonit të Opojës, dhe Kosovës në përgjithësi, si dhe regjistrimi i gjendjes së valles në vitet ’80, si referencë për krahasim me gjendjen e saj sot, në kontekst të ndryshimeve të mëdha në Kosovë. Përderisa folkloristët kanë qenë kryesisht të fokusuar në mbledhjen e teksteve, prej ninullave deri te këngët epike, Reineck-u si antropologe ka mbledhur, regjistruar e dokumentuar, por edhe interpretuar e krahasur vallen shqiptare të Opojës, si performancë kulturore brenda fshatit, dhe në kontekstin e saj të përditshëm kulturor, duke prodhuar një interpretim të thukët të valleve të dasmës si performancë.

Megjithatë, fokusi kryesor antropologjik i saj del në pah në temën e doktoratës, të mbrojtur në vitin 1991, duke u bazuar në punën e saj në terren të realizuar gjatë viteve ’80, por më specifikisht gjatë viteve 1986-1988. Në tezën e doktoratës mbi Opojën, Janet Reineck pohon se “shqiptarët e kërkojnë ‘strehën në të kaluarën’ si mbrojtje ndaj një situatë politike dhe ekonomike gjithnjë e më shtypëse. Në këtë kontekst, ‘tradita’ kërkohet që të lartësojë dhe përforcojë identitetin kolektiv”.<sup>41</sup> Kjo tezë përbën boshtin e punës së saj, ku theksohet se e kaluara funksionon si një burim sigurie, ndërkohë që moderniteti shfaqet si kërcënim. Sipas saj, migrimi, që shpesh pritet të sjellë ndryshim, në fakt përforcon konservatorizmin. Ajo vëren se “migrantët që kthehen nga jeta jashtë vendit ....rrallë herë sjellin ide ose perceptime të reja në botëkuptimin vendas. Përkundrazi, respekti i tyre ndaj qëndrimeve dhe zakoneve nga e kaluara tenton të

39 J.Reineck, *Wedding Dances from Kosovo, Yugoslavia: Structural and Contextual Analysis*, MA Dissertation, University of California, Los Angeles, 1985, f.20

40 Po aty, 37

41 Janet Reineck, *E kaluara si strehë*, f.270

thellohet<sup>42</sup>. Në vend që hapë rrugë për braktisjen e strukturave të vjetra, migrimi i mbështet ato. Reineck-u nxjerr në pah se migrantët shqiptarë, edhe pse sjellin përmirësime materiale në vendlindje, ideja e kthimit dhe lidhja emocionale me komunitetin bën që ata të mbeten konservatorë në botëkuptim dhe të mos përcjellin ndryshime ideologjike, duke e parë emigrimin vetëm si një mjet ekonomik për një jetë më të mirë, jo për një jetë të re. Kësisoj, sipas saj, botëkuptimi patriarkal nuk zbutet nga këto procese, por rihet përmes kontrollit mbi gratë që mbesin në shtëpi në atdhe. Reineck-u shkruan se “kontrolli i të zotit mbi gratë bëhet përmes *zotës së shtëpisë* e cila i drejton aktivitetet e tyre. Zoja është ose gruaja e të zotit ose një grua e moshuar e familjes e aftë për të udhëhequr<sup>43</sup>. Kështu, sistemi mbetet i mbyllur, sepse edhe kur burrat emigrojnë, rendi patriarkal ruhet përmes grave të moshuara që mbajnë pushtetin mbi gratë e reja të ardhura në familje.

Pra, në Opojën e viteve '80, vazhdimësia me të kaluarën del në pah më shumë se sa gulçimi drejt progresit për të ardhmen, edhe në rastet e migrantëve opojanë që dalin dhe shohin praktikatat të reja në vendet e Evropës Përqendrore. Sipas saj, “ndër shqiptarët e Opojës spikatet vazhdimësia me të kaluarën përballë një horizonti të ndryshimit që duket goxha i largët... martesat e mësituara, ritualet e aleancës, qëndrimet rreth emigrimit dhe mohimi i arsimimit të grave<sup>44</sup>. Kështu, teza kryesore e Reineck-ut është se “e kaluara” për shqiptarët nuk është nostalgji, por një strehë apo një mënyrë për të ruajtur identitetin, patriarkalitetin dhe solidaritetin familjar në kushte kur migrimi, varfëria dhe shtypja politike e bënë të ardhmen të pasigurt. Relevanca e argumenteve të Janet Reineck-ut nuk qëndron vetëm në përshkrimin e Opojës dhe Kosovës, por në mënyrën se si ato e ndërlidhin antropologjinë mbi shqiptarët me antropologjinë më të gjerë të Ballkanit dhe Evropës Juglindore. Reineck-u tregon se në Opojë, migrimi shpesh e forcoi ruajtjen e traditës dhe sundimit patriarkal. Ky është një kontrast i rëndësishëm krahasues: përderisa ekziston një përshtypje e përgjithshme se migrimi shërbeu si mundësi për ndryshim, te shqiptarët e Kosovës ai u bë edhe mekanizëm mbrojtës dhe konservativ. Studimi i saj, ndonëse i bazuar në etnografi të ngjeshur, shpesh gëlon nga kritika për konservatorizmin e ushqyer edhe nga “migrantët që kanë dalë e parë botën”, por nuk thekson sa duhet edhe ndryshimet që migrantët sjellin vendet e tyre. Prandaj, argumenti i saj formësohet edhe nga mungesa e matjes efektive të ndikimit të migrantëve dhe punëtorëve sezonalë në vendin e originës.

Në aspektin gjinor, studime të tjera në rajon, si ato të Tone Bringa mbi

42 Po aty., 214

43 Po aty., 91

44 Po aty., 251

gratë myslimane në Bosnjë,<sup>45</sup> tregojnë se rolet gjinore vazhduan të mbesin të forta edhe nën socializëm, megjithëse retorika zyrtare predikonte barazi gjinore. Reineck-u e konfirmon këtë prirje për Kosovën, por shton një element specifik: roli i zotës së shtëpisë si mekanizëm i brendshëm i patriarkatit, që garanton vazhdimësinë edhe kur burrat janë të emigruar. Ky vërejtje i hershëm e pasuron literaturën e antropologjisë gjinore të rajonit, duke treguar se sistemi patriarkal nuk mbështetet vetëm te burrat, por edhe te strukturat gjinore të brendshme. Po ashtu, në aspektin krahasimtar, duhet theksuar se antropologët si Katherine Verdery, potencojnë se tradita shpesh u instrumentalizua nga shteti socialist, si në rastin e Rumanisë, për të prodhuar një imazh të unitetit kombëtar.<sup>46</sup> Në Kosovë, sipas Reineck-ut, tradita u përdor nga shqiptarët si strategji për t'u ballafaquar me shtetin socialist, për të ruajtur identitetin dhe autonominë e tyre. Ky krahasim tregon se “tradita” ka shumë kuptime në kontekstin komunist; ajo mund të jetë instrument shtetëror ose rezistencë komunitare, varësisht nga raportet e pushtetit. Reineck-u i dha antropologjisë së rajonit tri gjëra të reja: Kosova doli në pah edhe si hapësirë e konservimit të traditës, ndryshe nga tendencat modernizuese në pjesë të tjera të Jugosllavisë; gjinia doli në qendër të analizës, duke shkuar përtej përshkrimit të thjeshtë të familjes; Kosova u lidh me debatet më të gjera të antropologjisë së migrimit dhe diasporës, duke e bërë të krahasueshme me rastet e tjera të Evropës Juglindore dhe më gjerë.

Duhet theksuar se në kontekst të referencialitetit të krijuar nga Backer dhe Reineck, studimi antropologjik mbi familjen vazhdoi edhe në periudhën postsocialiste dhe atë të pasluftës, ku tre antropologë realizuan hulumtimet e tyre antropologjike mbi ndryshimet/transformimet në familje në Kosovë: Carolin Leutloff-Grandtis, Tahir Latifi dhe Eli Krasniqi, për të shkruar punime doktorate, libra të hulumtimit të habilitacionit dhe ese.<sup>47</sup>

---

45 T. Bringa, *Being Muslim the Bosnian Way: Identity and Community in a Central Bosnian Village*, Princeton, Princeton University Press, 1996

46 K., *Transylvanian Villagers: Three Centuries of Political, Economic, and Ethnic Change*, Berkeley, University of California Press, 1983

47 Në seksion e Historisë dhe Antropologjisë së Evropës Juglindore, projekti i mentoruar nga Karl Kaser, që edhe vetë kishte shkruar një mori studimesh për familjen në Ballkan, i quajtur “Familja në Kosovë – e rivizituar” u fokusua te studimi i familjes shqiptare në Kosovë, me fokus në Isniq dhe Opojë, duke pasur për referencë krahasimtare kryesore punën e Berit Backer-it dhe Janet Reineck-ut. Anëtarët e grupit hulumtues: Carolin Leutloff-Grandtis, Tahir Latifi dhe Eli Krasniqi. Studimi i Leutloffs-Grandtis (habilitacion) ka rezultuar në libër ( C. Leutloffs-Grandtis, *Translocal Care Across Kosovo's Borders: Reconfiguring Kinship along Gender and Generational Lines*, Berghahn, New York/Oxford, 2023), ndërsa Tahir latifi dhe Eli Krasniqi kanë shkruar doktoratat (shih: Tahir Latifi, *Family, Kinship Relations and Social Security in Kosovo since the War of 1999*, dissertation thesis, University of Graz, 2015; Elife Krasniqi, *Family and*

## Duijzings

Në librin e tij *Religjioni dhe politikat e identitetit në Kosovë*, Ger Duijzings ndërton një argument themelor për ta kuptuar shoqërinë kosovare përtej skemave të ngurta të ndarjes etnike, apo identitetit të fiksuar.<sup>48</sup> Ai e sheh identitetin si proces të vazhdueshëm, fluid dhe të kontestuar, ndërsa religjioni nuk shfaqet si një fushë e izoluar e jetës kulturore, por si një instrument i pandashëm i politikave të identitetit. Ai thekson se,

“praktika kulturore në Ballkan mund të përshkruhet më së miri si e përzier, heterogjene, kontradiktore, e fragmentuar dhe jokohërente (ose e ‘kreolizuar’ për të përdorur termin më në modë - post-moderne), të paktën nga pikëpamja e ortodoksive kombëtare dhe fetare. Qendrat e pushtetit politik dhe fetar janë përpjekur ta kapërcejnë këtë situatë: janë përpjekur të zhdukin këto elemente të përzierjes dhe ‘orientimeve’ të shumta etnike dhe fetare, dhe kanë bërë presion për identitete të qarta të vetme, me ose pa mjete të dhunshme, dhe kryesisht me sukses të ndryshëm dhe të kufizuar.”<sup>49</sup>

Duijzings është në përpjekje për të deskonstruktuar, siç shprehet ai, formësimin e identitetit politik, kombëtar e etnik – me fokus në Kosovë, por duke pasur parasysh gjithë Ballkanin - duke treguar se si shteti modern, apo modeli evropian i shtetit modern, është legjitimues i krijimit identitar, në vendet ballkanike, ndonëse identitetet etnike e fetare kanë qenë më fluide, kur shihen në kontekst të praktikave të jetës së përditshme të popujve të ndryshëm në Ballkan. Rasti i Kosovës është marrë si shembull për të demonstruar këtë aspekt të shpërndërimit identitar, duke provuar identitetin laraman, praktikat sinkretike, identitetet e reja etnike (egjiptianët), sektarianizmin të shqiptarët e besimit islam e me radhë. Duijzings sjellë një perspektivë për shtigje anësore, fenomenet që shpesh nuk kapen nga vëmendja e autorëve të tjerë. Pra, për ta vrojtuar relievin identitar, pa ngurtësime të mëdha, pa ishullime strikte, por si relief të shpërndërrueshëm, që ndryshon. Kjo përpjekje është mjaft e guximshme, sidomos në kontekst të studimit të identitetit kulturor e politik në Kosovën e viteve '90. Ai e arsyeton studimin e tij, duke dashur

---

*Patriarchy in Kosovo. Changes and Continuities from mid-20th to early 21st century*, dissertation thesis, University of Graz, 2018]. Për më tepër, shih edhe kapitullin: T. Latifi & E. Krasniqi, *Changes and Continuities in the Kosovo Albanian Family Following the War of 1998/99, as Evidenced in Isniq and Opoja*, in S. Gruber, D. Gutmeyr, S. Jesner, E. Krasniqi, R. Pichler, C. Promitzer (eds) *From the Highlands to Hollywood Multidisciplinary Perspectives on Southeastern Europe*, LIT Verlag, Wien, 2020, f.265-286.

48 G. Duijzings, *Religjioni dhe politikat e identitetit në Kosovë*, Cuneus, Prishtinë, 2024,

49 Po aty., 256

që të ndjek de-esencializimin e identitetit kombëtar, bazuar në etni dhe religion, përmes fokusit të vendosja në pah dhe studimi i vendeve ku ka gërshetime, mjegullime e shpërndërrime.

“Kam zgjedhur të mos ndjek këto rrugë të shkelura mirë dhe të përqendrohem në tema që zakonisht i shpëtojnë vëmendjes së atyre autorëve. Unë besoj se antropologjia mund të ofrojë shumë njohuri shtesë - thjesht duke hyrë në shtigje anësore të vogla dhe të panjohura - të cilat në fund do të hapin perspektiva të reja për problemet e vjetra”.<sup>50</sup>

Këto “shtigje anësore” janë për shembull pelegrinazhet e përbashkëta dhe hijeroret e dykuptimshme, të cilat nuk përshtaten në kornizën botëkuptimore të ndarjes së ngurtë ndërmjet islamit dhe krishterimit. Duijzings rrëfen se “myslimanët dhe të krishterët me prejardhje të ndryshme etno-fetare kanë vizituar faltoret e njëri-tjetrit, kanë ndarë adhurimin e shenjtoreve të caktuar dhe shpesh i kanë shpërfillur kundërshtimet e priftërinjve të tyre për tejkalim të kufijve fetarë. Në këtë sinor të dy religjioneve të mëdha, format e krishtera dhe myslimane të pelegrinazhit dhe adhurimi i shenjtoreve janë shkrirë, përkundër faktit se grupet e ndryshme etno-fetare kanë vazhduar në konflikte të athëta”<sup>51</sup>. Ky shembull është domethënës si objekt etnografik për modelin teorik që ai projekton, sepse kritikon narrativën e pastërtisë etnike dhe fetare, duke treguar se, sipas këtij autori, Kosova nuk është një hapësirë e homogjenitetit, por e ndërthurjeve. Pra, vrojtimi i tij ndalet më shumë te çarjet, ndërthurjet, përshtatjet e përthyerjet, jo aq te ngulitjet, dominimet, linearitetet e aspektet tjera dominante. Në vitet '90 kur shkruan disertacionin, Duijzings ishte veçse në rrjedhë të antropologjisë bashkëkohore, ku dominonin interpretimet mbi alteritetin e diferencën në kontekst të politikave identitare, që kishte marr hov në kuadër të studimeve postmoderne, përmes së cilës synohej de-esencializimi i narracioneve të mëdha identitare.<sup>52</sup> Dhe,

50 Po aty., f.59

51 Po aty., f. 122

52 Duket se Duijzings ishte mjaft i influencuar nga puna e Thomas Hylland Eriksen-it mbi etninë dhe nacionalizmin, të cilit i referohet mjaft në libër, por edhe nga e gjithë fryma e studimeve mbi etniciteti të nisura nga Fredrik Barth, ku fokusi studimor duhet të bie më shumë te kufijtë mes etnive, jo përmbajtja esencjaliste e tyre, për ta vërejtur mënyrën se si fomësohen e mirëmbahen identitetet etnike. Shih: T.H. Eriksen, *Ethnicity and nationalism: Anthropological perspectives*, London, Pluto Press, 1993. Eriksen stërthekson qasjen konstruktiviste e kontekstuale të formësimit të identitetit e jo esencjalizmin e “autenticitetit”. Duijzings synon të njëjën gjë, duke dashur të gjejë çarjet në shoqërinë kosovare, mes shqiptarëve, serbëve, katolikëve, myslimanëve, ortodoksëve, egjiptianëve – pra duke e de-hegjenomizuar perspektivën antropologjike nga pikëpamja për grupin dominat. Kjo e bën atë më pranë qasjeve postmoderne që mbretëtonin asaj kohe.

ai konceptualizon kërkimin e tij mbi premisat e kësaj përspektive. Po japim një paragraf më të gjatë për të treguar habinë e antropologut me gjendjen identitare në rajonin e Vitisë, gjegjësisht të grykës së Letnicës e Stubllës në Kosovë:

“Ajo çfarë më la pa fjalë në këtë zonë ishte dykuptimësia dhe ndërrimi i identiteteve. Shpesh i bëja pyetje vetes: “Kush është kush mirëfilli, dhe ç’rrenjë kanë pasur?” Shqiptarët në Stubëll sot janë katolikë, por më herët kanë qenë myslimanë ose, që të jem më i saktë, ishin katolikë dhe muslimanë njëherësh. Varësisht nga nevojat e caktuara të një rrethane, ata zgjidhnin njërin nga opsionet. Gratë katolike të Stubllës ende veshin dimija, veshje haremi që tani i veshin vetëm gratë myslimane, dhe janë ruajtur edhe shprehi të tjera myslimane. Sidoqoftë, disa banorë të Letnicës mëtojnë se shqiptarët e Stubllës janë me origjinë kroate katolike, të cilët në kohën e turkut qenë islamizuar dhe paskëtaj shqiptarizuar. Në kohën kur po kryeja hulumtime në terren më 1992, banorët e Vërnakollës, fshat pranë Stubllës, sot gati i braktisur, ishin kroatë. Por shumë prej tyre kam dëgjuar të flasin shqipe të kulluar, ndryshe nga kroatët e tjerë, të cilët normalisht nuk e dinë dhe thjesht nuk duan ta mësojnë shqipen. Ata kishin lidhje tradicionale martesore me shqiptarët në Stubëll dhe ishin shumë më shumë të drejtuar nga Stublla se nga katundthi kroat i Letnicës, të cilit i përkitnin formalisht.”<sup>53</sup>

Në mënyrë të ngjashme, rastet e minoriteteve të vogla, si kroatët e Letnicës, tregojnë sesi politika dhe kombësia ripozicionojnë dhe ndërprejnë praktikën fetare. Përshkrimi i tij mbi eksodin e kroatëve të Letnicës dhe ngulitjen e tyre në Sllavoni, është kronikë etnografike e kohës që do të mbijetojë edhe si dokumentim humanist.

Një rast tjetër i veçantë janë kripto-katolikët shqiptarë, të cilët për shekuj kishin fshehur besimin e tyre për shkak të presioneve politike dhe shoqërore. Duijzings vëren se martirët e Stubllës dhe praktikën e kripto-katolikëve shqiptarë tregojnë se kufijtë ndërmjet feve nuk kanë qenë kurrë të fortë, por shpesh të përshkueshëm dhe të manipuluar për mbijetesë në kushte të presionit shtetëror. Kjo flet qartë për natyrën ambivalente të identitetit fetar dhe mënyrën se si religjioni mund të përdoret si strategji përshtatjeje. Duijzings këtu jep shembull se edhe në vendin si Kosova,

53 Po aty, 78. Megjithatë, duhet të theksojmë se po të kishte kohë të mjaftueshme enografike, ndoshta Duijzings do ta kishte më të qartë, që ta shyrqonte më me ngë, raportin etnike e fetar në këtë rajon, por edhe në gjithë Kosovën. Duket sikur etnografia sipërfaqësore në këto fshatëra dhe mosnjohja e kontekstit social në plotinë e vet, ka qenë shkak që ta ngjesh më lehtë e shpejt këtë brum etnografik si evidencë për “përzierjet” e “shpërndërrimet” identitare.

që konsiderohet që i përket me shumicë besimit islam, ka fluiditet në identitetin fetar. Në anën tjetër, sipas tij, rendet e dervishëve ilustrojnë një traditë fetare ku ndërthurja është normë, jo përjashtim.

Me këtë interpretim antropologjik të shoqërisë kosovare, menjëherë pas luftës 1998-1999, Duijzings tërheq vëmendjen te aspektet më pak dominante në sferën politike, si dhe tregon për potencialitetin e identitetit fluid edhe në rastin e një vendi që shquhet për antagonizëm identitar shqiptar-serb, siç qe bërë e njohur Kosova e viteve 90, e sidomos gjatë luftës. Duijzings e vrojton Kosovën përmes një optike më të gjerë antropologjike, veçon komunitete marginale, heton raste specifike fetare sikurse praktikat sinkretike, dhe rrëfen një tregim për identitetin si të shpërndërrueshëm në një vend ku konsiderohej se lufta për identitet kombëtar është imanente. Sado që nga pikëpamja e “interpretimit të thukët”, siç do të sugjeronte Clifford Geertz, monografia e Duijzings-it mund të kritikohet në disa aspekte, duhet theksuar kureshtjen dhe guximin për të përbiruar Kosovën nëpër vrimë të gjilpërës së de-esencializimit të identitetit, në kontekst të kohës së botimit të këtij teksti. Duijzings-i e konsideron Letnicën si “laborator i identitetit”<sup>54</sup> dhe evidenca që ai sjell për aspektin religjioz, sidomos, mbron tezën e tij se religjioni nuk mund të shihet i ndarë nga politika dhe se identitetet, sidomos ato fetare, nuk janë kurrë statike. Përkundrazi, ato janë gjithmonë të negociuara, të manipuluar dhe të riprodhuara, aq sa edhe bëhen evidenca heterogjeniteti kundruall përfytyrimeve ideologjike për homogjenitet. Në këtë sens, Kosova bëhet për Duijzings-in një hapësirë përndjellëse për ta kuptuar se si politika, historia dhe religjioni ndërthuren për të prodhuar identitete fluide dhe kontradiktore, një referencë që është e vlefshme për ta diskutuar në kontekst të identitetit në rajon.

## Përfundim

Si mund të karakterizohen perspektivat e këtyre tre antropologëve të huaj që studiuuan shoqërinë kosovare, gjatë regjimit jugosllav? Studimet e Berit Backer, Janet Reineck dhe Ger Duijzings mbi Kosovën gjatë periudhës së Jugosllavisë komuniste, përbëjnë një portë të veçantë hyrjeje në historinë e antropologjisë shqiptare dhe të Europës Juglindore. Ajo që i bën ata unikë nuk është vetëm fakti se erdhën si të huaj për të hulumtuar një shoqëri të marginalizuar brenda një shteti komunist, por edhe mënyra se si secili prej tyre solli një optikë të ndryshme teorike dhe metodologjike, duke krijuar një triadë që mund të shihet si pasqyrë e zhvillimit të vetë antropologjisë europiane në dekadat e fundit të shekullit njëzet.

Në përkryesë të këtij venerimi duhet të përmbledhi edhe njëherë jehonën e *tre musketarëve*. Berit Backer ishte e para që theu akullin. Ajo erdhi në

---

54 Po aty, 126

Kosovë në vitet '70, në një kohë kur etnologjia jugosllave ishte e ngarkuar nga ideologjia komuniste dhe prirej të prodhonte imazhe të folklorizuara të kulturës shqiptare, duke e trajtuar atë më shumë si material për propagandën e unitetit socialist sesa si realitet i gjallë shoqëror. Në fshatin Isniq, Backer u fut “pas mureve të gurit” dhe tregoi jetën e përditshme të familjes shqiptare në të gjitha dimensionet e saj: marrëdhëniet breznore, rolet gjinore, organizimin e punës, ndarjen e pronës dhe tensionet mes traditës dhe modernizimit. Ajo argumentoi se familja e madhe patriarkale nuk ishte thjesht një relik i së kaluarës, por një institucion që përshtatej dhe riorganizohej sipas kushteve të kohës. Ky vështrim e bëri punën e saj të pazëvendësueshme, sepse ishte një analizë e ndershme dhe empirike, që mungonte në botimet e etnologëve vendorë. Ajo krijoi një terren të besueshëm për ata që erdhën më pas.

Në vitet '80, Janet Reineck zhvendosi vëmendjen nga struktura e ngurtë e familjes të lëvizja dhe ndryshimi, duke u përqendruar në migrimin dhe gjininë. Për të, Kosova dukej ende një hapësirë e stagnimit social ku migrimi i burrave në qytetet jugosllave dhe në Perëndim shërbente si një formë e dyfishtë: nga njëra anë siguronte mjete ekonomike për mbijetesë, por nga ana tjetër e ngurtësonte patriarkatin, duke e lënë gruan të lidhur më fort pas rolit tradicional të shtëpisë. Reineck e konceptoi “të kaluarën” si një strehë konservative, një formë mbrojtjeje ndaj pasigurive të modernizimit dhe të marginalizimit ekonomik e politik. Në këtë kuptim, ajo i dha antropologjisë së Kosovës një dimension simbolik, duke treguar se familja dhe tradita nuk ishin thjesht institucione praktike, por edhe sisteme kuptimore ku njerëzit projektonin sigurinë dhe identitetin e tyre.

Në vitet '90, Ger Duijzings solli një qasje krejt tjetër. Në vend që të përqendrohej vetëm te familja ose migrimi, ose vetëm te një komunitet etnik, ai shikoi pluralitetin dhe fluiditetin e identitetit në Kosovë. Ai studioi dervishët, egjiptianët, kroatët katolikë të Letnicës, pelegrinazhet e përbashkëta myslimane e të krishtera dhe tregoi se Kosova nuk ishte një shoqëri homogjene, por një mozaik komunitetesh, religjionesh dhe identitetesh që shpesh përplaseshin e shpesh gërshetoheshin me njëra-tjetrën. Për Duijzings-in, religjioni dhe identiteti nuk ishin kategori të ngurta, por fusha beteje ku politika dhe historia krijonin vazhdimisht kuptime të reja. Në këtë mënyrë ai e futi Kosovën në horizontin e antropologjisë post-socialiste dhe postmoderne, duke e paraqitur si një laborator të fluiditetit identitar.

Së bashku, këta tre autorë përbëjnë një triadë që pasqyron vetë zhvillimin e antropologjisë në Europën Juglindore: nga struktural-funksionalizmi i Backer-it mbi familjen, te antropologjia simbolike dhe e gjinisë e Reineck-ut, e deri te perspektiva postmoderne de-sesencialiste i Duijzings-it mbi identitetin. Nëse Backer tregoi bazën strukturore të jetës shqiptare,

Reineck analizoi mekanizmat që e ruanin apo e ndryshonin këtë strukturë nëpërmjet migrimit, ndërsa Duijzings shpërfaqti heterogjenitetin dhe konfliktin që shoqëria e Kosovës kishte brenda vetes. Pra, tre musketarët nuk janë vetëm etnografë të Kosovës, por janë tre shtylla referenciale të antropologjisë perëndimore të gjysmës së dytë të shekullit XX dhe fillimit të shekullit XXI në Evropën Juglindore, të cilat vendosin edhe Kosovën, si objekt etnografik të transformimeve socialiste, duke u fokusuar në temat e familjes, gjinisë, migrimit dhe identitetit. Në saje të studimit antropologjik të këtyre antropologëve, Kosova u bë pjesë e pandarë e reflektimit teorik mbi shoqëritë socialiste dhe post-socialiste, duke dhënë shembull se margjinat shpesh janë vendet më adekuate për të kuptuar qendrën.

## BIBLIOGRAFIA

- Backer, B. *Prapa mureve të gurit: ndryshimi në organizimin e familjes të shqiptarët e Kosovës*. Cuneus, Prishtinë, 2025.
- Backer, B. *Behind Stone Walls: Changing Household Organisation among the Albanians of Kosova*. Pejë: Dukagjini Balkan Books. 2003.
- Backer, B. *Behind Stone Walls: Changing Household Organisation among the Albanians of Kosovo*. Edited by Robert Elsie and Antonia Young; photographs by Ann Christine Eek. London: Centre for Albanian Studies, 2015.
- Boem, C. *Blood Revenge: The Anthropology of Feuding in Montenegro and Other Tribal Societies*. University Press of Kansas, Lawrence, 1984.
- Bardhoshi, N. & Canolli, A. "Kosova antropologjike." Në N. Bardhoshi & A. Canolli (eds), *Kosova Antropologjike*. ASA, Tiranë, 2020, f. 7–50.
- Bardhoshi, N. & Lelaj, O. *Etnografi në diktaturë: dija, shteti dhe holokausti ynë*. ASHSH, Tiranë, 2018.
- Bardhoshi, N. "Ethnography of Law in Dictatorial Situation." Në A. Bošković & C. Hann (eds), *The Anthropological Field on the Margins of Europe 1945–1991*. Lit Verlag, Berlin, 2013, f. 175–189.
- Bringa, T. *Being Muslim the Bosnian Way: Identity and Community in a Central Bosnian Village*. Princeton University Press, Princeton, 1996.
- Brunnbauer, U. "A Promising Liaison? Social History and Anthropology in Southeastern Europe: Opportunities and Pitfalls." *East Central Europe/ECE* 34–35, 2007–2008, f. 161–184.
- Canolli, A. "Nga gurra e traditës te gurra e kritikës: aspekte të mendimit etnologjik të Mark Krasniqit." *Antropologjia* 3/1, 2020, f. 5–42.
- Canolli, A. *Rrënjë, rrugëtime, rropatje: interpretime antropologjike*. Cuneus, Prishtinë, 2022.

- Creed, G. *Domesticating Revolution: From Socialist Reform to Ambivalent Transition in a Bulgarian Village*. Pennsylvania State University Press, University Park, 1998.
- Duijzings, G. *Religion and the Politics of Identity in Kosovo*. Hurst, London, 2000.
- Duijzings, G. *Religjioni dhe politikat e identitetit në Kosovë*. Cuneus, Prishtinë, 2024.
- Eek, A. C. "Berita: Mikesha norvegjeze e shqiptarëve." Në B. Backer, *Prapa mureve të gurit: ndryshimi në organizimin e familjes te shqiptarët e Kosovës*. Cuneus, Prishtinë, 2024, f. 18.
- Eek, A. C. *Jeta në fshatin shqiptar – Isniq, Kosovë 1976*. Translated by Avni Spahiu. Sweden: Tira Books (ACE-EEK Books Norway), 2021
- Eriksen, T.H. *Ethnicity and nationalism: Anthropological perspectives*, London, Pluto Press, 1993
- Galaty, M. & Watkinson, C. "The Practice of Archaeology under Dictatorship." Në M. Galaty & C. Watkinson (eds), *Archaeology under Dictatorship*. Springer, New York, 2007, f. 1–18.
- Godina, V. "From Ethnology to Anthropology and Back Again: Negotiating the Boundaries of Ethnology and Anthropology in Post-socialist European Countries." Në P. Skalnik (ed.), *A Post-communist Millennium: The Struggles of Sociocultural Anthropology in Central and Eastern Europe*. Set Out, Prague, 2002, f. 1–22.
- Hammel, E. *Alternative Social Structures and Ritual Relations in the Balkans*. Prentice Hall, Englewood Cliffs, NJ, 1968.
- Hammel, E. "Economic Change, Social Mobility and Kinship in Serbia." *Southwestern Journal of Anthropology* 25, 1968, f. 188–197.
- Halpern, J. *A Serbian Village*. 2nd ed. Harper, New York, 1967.
- Halpern, J. *A Serbian Village in Historical Perspective*. 1967.
- Hann, C. "Introduction: Nations and Nationalism, Societies and Socialism, Fields and Wars." Në A. Bošković & C. Hann (eds), *The Anthropological Field on the Margins of Europe 1945–1991*. Lit Verlag, Berlin, 2013, f. 1–28.
- Hann, C. "Beyond Cold War, Beyond Otherness: Some Implications of Socialism and Postsocialism for Anthropology." Në C. Giordano, F. Ruegg & A. Boscoboinik (eds), *Does East Go West?: Anthropological Pathways through Postsocialism*. LIT, Münster, 2014, f. 35–56.
- Hedeşan, O. "Doing Fieldwork in Communist Romania." Në I. Mihăilescu, I. Iliev & S. Naumović (eds), *Studying Peoples in the People's Democracies II*. Lit Verlag, Berlin, 2008, f. 21–39.
- Hysa, A. "Ethnography in Communist Albania: Nationalist Discourse and Relations with History." *Historični seminar* 8, 2010, f. 103–125.
- Ivanova, R. "New Orientations in Bulgarian Ethnology and Folkloristics."

- Ethnologia Balkanica* 2, 1998, f. 225.
- Lockwood, W. *European Moslems: Economy and Ethnicity in Western Bosnia*. Academic Press, New York, 1975.
- Malcolm, N. *Kosovo: A Short History*. Macmillan, Basingstoke, 1998.
- Obrebski, J. *Ritual and Social Structure in a Macedonian Village*. University of Massachusetts, Amherst, 1977.
- Pokonjak, S. "In Women's Arms: Croatian Ethnology between 1945 and 1990." Në A. Bošković & C. Hann (eds), *The Anthropological Field on the Margins of Europe 1945–1991*. Lit Verlag, Berlin, 2013, f. 237–258.
- Reineck, J. *Wedding Dances from Kosovo, Yugoslavia: A Structural and Contextual Analysis*. MA dissertation, University of California, Los Angeles, 1985.
- Reineck, J. *The Past as a Refuge: Gender, Migration and Ideology among the Kosova Albanians*. PhD dissertation, University of California, Berkeley, 1991.
- Reineck, J. *E kaluara si strehë: Gjinia, migrimi dhe ideologjia te shqiptarët e Kosovës*. Cuneus, Prishtinë, 2024.
- Reineck, J. *Një Amerikane në Kosovë 1981–1997*. Cuneus, Prishtinë, 2022.
- Rice, T. *May It Fill Your Soul: Experiencing Bulgarian Music*. University of Chicago Press, Chicago, 1994.
- Silverman, C. "The Politics of Folklore in Bulgaria." *Anthropological Quarterly* 56/2, 1983, f. 55–61.
- Todorova, M. *Myth-Making in European Family History: the Zadruga Revisited*, "East European politics and societies", 1990, 4/1, f. 30-76
- Valtchinova, G. "Folkloristic Ethnography or Anthropology: Bulgarian Ethnology at the Crossroads." *Journal of Society for Society of Europe* 4/2, 2004, f. 2–18.
- Verdery, K. *Transylvanian Villagers: Three Centuries of Political, Economic, and Ethnic Change*. University of California Press, Berkeley, 1983.
- Verdery, K. *What Was Socialism and What Comes Next?* Princeton University Press, Princeton, 1996.
- Verdery, K. *My Life as a Spy: Investigations in a Secret Police File*. Duke University Press, Durham, 2018.
- Winner, I. *A Slovenian Village: Žerovnica*. Brown University Press, Providence, RI, 1971.

